

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Faton Bajrami duke vendosur lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë të propozuesit VAPIK – Shoqata për Administrimin Kolektiv të të Drejtave të Autorit dhe të drejtave të përafërta Autorët Vizuale Producent dhe interpretuesit e Kosovës e përfaqësuar sipas autorizimit nga Florin Lata, avokat nga Prishtina kundër kundërshtarëve të masës siguruese Ipko Telecommunications LL.C, Artmotion sh.p.k, Kujtesa Net sh.p.k, Telkos LL.C të gjitha me seli në Prishtinë, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Isamedin Dedinca, avokat nga Prishtina, dhe Telekom i Kosovës sh.a me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Gazmend Nushi, avokat nga Prishtina, duke vendosur përkitazi me kërkesën për lirim nga pagesa e garancionit, jashtë seancës, me date 12.08.2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET kërkesa e propozuesit të sigurimit VAPIK – Shoqata për Administrimin Kolektiv të të Drejtave të Autorit dhe të drejtave të përafërta Autorët Vizuale Producent dhe interpretuesit e Kosovës për lirim nga pagesa e garancionit.

A r s y e t i m

Propozuesi i sigurimit VAPIK – Shoqata për Administrimin Kolektiv të të Drejtave të Autorit dhe të drejtave të përafërta Autorët Vizuale Producent dhe interpretuesit e Kosovës e përfaqësuar sipas autorizimit nga Florin Lata avokat nga Prishtina, pranë kësaj gjykate ka paraqitur propozimin për caktimin e masës së sigurimit ndaj kundërshtarëve të sigurimit Ipko Telecommunications LL.C, Artmotion sh.p.k, Kujtesa Net sh.p.k, Telkos LL.C, Telekom i Kosovës sh.a, të gjitha me seli ne Prishtinë.

Gjykata me aktvendimin V.EK.nr.413/21 të datës 28.07.2021 ka kërkuar nga propozuesi i sigurimit që të paguajë garancionin ne lartësi prej 5,000.00 euro, ne afat prej 7 ditësh, i cili do te shërbente si garanci për dëmin që mund t’ju shkaktohet palëve kundërshtare me caktimin dhe ekzekutimin e masës së sigurimit.

Propozuesi i sigurimit me parashtresën e datës 10.08.2021 ka njoftuar gjykatën se është në pamundësi financiare që të paguajë garancionin si në aktvendim, duke propozuar që të lirohet nga pagesa e garancionit. Më tutje në parashtresë propozuesi i sigurimit ka theksuar se në kuptim të ligjit është paraparë që të hyrat për veprimtarinë e saj të i inkasojë nga administrimi kolektiv i të drejtave të autorit, mirëpo përkundër rregullativës ligjore tash e sa vite nuk ka arritur që t’i inkasojë mjete nga operatorët kabllor (këtu kundërshtarët e sigurimit) andaj gjendja e llogarisë financiare e propozuesit të sigurimit është 0 (zero), pra propozuesi i sigurimit është ë pamundësi financiare që të bëjë pagesën e garancionit. Mbi këtë bazë i ka propozuar gjykatës që në kuptim të nenit 297 par. 3, të lirohet nga pagesa e garancionit, duke prezantuar si provë gjendjen e llogarisë bankare.

Gjykata shqyrtoi kërkesën e propozuesit për lirim nga pagesa e garancionit, nga ku rezulton se kërkesa është e bazuar dhe nuk është kontestues as në mes të ndërgjyqësve fakti se

kundërshtarët e sigurimit nuk kanë kontribuar në asnjë formë në përmbushjen e detyrimeve ligjore ndaj propozuesit të sigurimit, e duke qenë se propozuesi të vetmet të hyra që mund t'i realizojë, pritet t'i inkasojë nga këtu kundërshtarët e sigurimit, e poashtu nga shiqimi në llogarinë bankare rezulton se propozuesi i sigurimit nuk ka mundësi financiare për pagesën e garancionit, andaj gjykata në kuptim të nenit 297, par. 3 vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Ekonomike

V.EK.nr.413 /21, me datë 12.08.2021

**Gjyqtari,
Faton Bajrami**

KËSHILLA JURIDIKE :Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:138723

Datë: 13.08.2021

Numri i dokumentit: 02084111

V.EK.nr.413/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Faton Bajrami duke vendosur në çështjen juridik të propozuesit se masës së sigurimit VAPIK – Shoqata për Administrimin Kolektiv të të Drejtave të Autorit dhe të drejtave të përafërta Autorët Vizuale Producent dhe interpretuesit e Kosovës e përfaqësuar sipas autorizimit nga Florin Lata avokat nga Prishtina kundër kundërshtarëve të masës siguruese Ipko Telecommunications LL.C, Artmotion sh.p.k, Kujtesa Net sh.p.k, Telkos LL.C të gjitha me seli në Prishtinë, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Isamedin Dedinca, avokat nga Prishtina, dhe Telekom i Kosovës sh.a me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Gazmend Nushi, avokat nga Prishtina, duke vendosur në lidhje me propozimin për caktimin e masës së sigurisë, ne seancë me datën 28.07.2021, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET si i bazuar propozimi i propozuesit të sigurimit VAPIK – Shoqata për Administrimin Kolektiv të të Drejtave të Autorit dhe të drejtave të përafërta Autorët Vizuale Producent dhe interpretuesit e Kosovës, e paraqitur kundër kundërshtarëve të sigurimit Ipko Telecommunications LL.C, Artmotion sh.p.k, Kujtesa Net sh.p.k, Telkos LL.C, Telekom i Kosovës të gjitha me seli në Prishtinë, ashtu që caktohet masa e sigurimit, me të cilën urdhërohen kundërshtarët e sigurimit që të ndërpresin transmetimin dhe ritransmetimin e lëndës së mbrojtur me të drejtën e autorit në platformat e tyre, e poashtu të gjithë kundërshtarëve të sigurimit iu bllokohen xhirrollogaritë bankare dhe atë secilës në shumë prej 250.000€.

II. Kjo masë e sigurimit hyn në fuqi menjëherë dhe mbetet në fuqi deri në vendimin e ardhshëm të gjykatës.

A r s y e t i m

Propozuesi VAPIK – Shoqata për Administrimin Kolektiv të të Drejtave të Autorit dhe të drejtave të përafërta Autorët Vizuale Producent dhe interpretuesit e Kosovës, përmes të autorizuarit të tij me datën 30.06.2021, pranë kësaj gjykate ka paraqitur propozimin për caktimin e masës së sigurisë ndaj kundërshtarëve të masës së sigurisë Ipko Telecommunications LL.C, Artmotion sh.p.k, Kujtesa Net sh.p.k, Telkos LL.C, Telekom i Kosovës të gjitha me seli në

Prishtinë. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet propozimi për caktimin e masës së sigurimit, ashtu që të caktohet masa e sigurimit me të cilën urdhërohen kundërshtarët e sigurimit që të ndërpresin transmetimin dhe ritransmetimin e lëndës së mbrojtur me të drejtën e autorit në platformat e tyre, e poashtu të gjithë kundërshtarëve të sigurimit iu bllokohen xhirollogaritë bankare dhe atë secilës në shumë prej 250.000€.

Propozuesi i masës së sigurimit, në propozim ndër të tjera ka theksuar se është shoqatë e themeluar me ligj për menaxhimin kolektiv të të drejtave të autorit, i licencuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Propozuesi në propozim ka theksuar se në kuadër të aktivitetit të saj ka përfaqësimin e autorëve vizual, producentëve dhe interpretuesve dhe në bazë të lejes së lëshuar nga organi kompetent MKRS bën menaxhimin kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta, për të drejtat e ritransmetimit kabllor dhe të drejtat e transmetimit nga shërbyesit medial dhe audio vizual. Propozuesi më tej ka theksuar se që nga themelimi dhe licencimi i saj, më datë 11.07.2012, në mënyrë të vazhdueshme ka bërë përpjekje që operatorët kabllor të fillojnë përmbushjen e detyrimeve ligjore në raport me të drejtat e autorit mirëpo përkundër të gjithave nuk është arritur marrëveshja për përcaktimin e tarifave dhe si rezultat i mungesave të tarifave, Qeveria e Kosovës më datë 19.10.2020 me vendimin 12/36 të plotësuar me vendimin e datës 30.10.2020 me numër 13/38 ka përcaktuar tarifatat të cilat operatorët kabllor janë të obliguar t'i paguajnë shoqatës, këtu propozuesit dhe këto tarifa janë përcaktuar mbi bazën e numrit të abonuesve më datë zbatimi nga data 01.04.2021. Pas miratimit të tarifave propozuesi ka njoftuar kundërshtarët e sigurimit, ka kërkuar të dhëna mbi numrin e abonuesve duke kërkuar përmbushjen e detyrimit mirëpo kundërshtarët nuk i janë përgjigjur detyrimit ligjor.

Propozuesi ka theksuar se në kuptim të Ligjit për të drejtat e Autorit, shërbimet mediale, audio-vizuale të licencuara nga Komisioni i Pavarur për Media, operatorët kabllor dhe operatorët tjerë që ofrojnë këto shërbime obligohen që të bëjnë transmetimin, ritransmetimin e programeve bazuar në marrëveshjet valide për të drejtat e autorit dhe këto marrëveshje do të jenë të gatshme vetëm pasi të jenë të regjistruara nga propozuesi. Propozuesi më tej ka theksuar se edhe në kuptim të ligjit për ndryshimin e ligjit për të drejtat e autorit, e drejta e ritransmetimit kabllor të veprave dhe të drejtave të përafërta mund të ushtrohen vetëm përmes një shoqate kolektive (siç është në këtë rast propozuesi) e cila ka ekskluzivitetin ligjor për mbledhjen e tarifave. Propozuesi më tej ka theksuar se të drejtën përkatësisht autorizimin e inicimit të veprimeve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore e ka në kuptim të ligjit, nenit 181 i LDA.

Në deklaratimet e theksuara verbalisht, propozuesi e sigurimit ka ritheksuar se këtu propozuesi ka licencë valide për përfaqësim në fushën e administrimit kolektiv për të drejtat e autorit, për të drejtat e ritransmetimit kabllor, të drejta këto të cilat ushtrohen ekskluzivisht përmes saj e që vërtetohet edhe përmes shkresës konfirmuese të lëshuar nga Qeveria e Kosovës - MKRS, më datë 27.07.2021, më të cilën shkresë konfirmuese konfirmohet edhe e drejta e propozuesit në mbledhjen e tarifave nga operatorët kabllor. Më tej propozuesi i ka prezantuar gjykatës letrën konfirmuese nga shoqatat simotra në shtetet për rreth dhe shtetet e Evropës, e të cilat kanë të drejta të njëjta me propozuesin. Mbi bazën e të lartëcekurave i ka propozuar gjykatës që propozimin për caktimin e masës së sigurimit t'a aprovojë si të bazuar pasi që nga theksimet e propozuesit është bërë e besueshme e drejta subjektive e cila buron nga ligji dhe licenca, e

poashtu është vërtetuar rreziku se pa caktimin e masës, pala kundërshtare do të pamundëson apo vështirëson realizimin e kërkesës.

Kundërshtari i parë, i dytë, i tretë dhe i katërt i sigurimit, përmes të autorizuarit të tyre ka kundërshtuar në tërësi propozimin për caktimin e masës siguruese si në përgjigjen e formës së shkruar më datë 08.07.2021, ashtu edhe me anë të kundërshtimeve të theksuara në seanca, me arsyetimin se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e masës së sigurisë në kuptim të nenit 297, par.1, pika a) dhe pika b) të LPK-së. Kundërshtarët e sigurimit në parashtrime kanë theksuar se në këtë çështje është e pabazuar padia e mbi këtë bazë e bën të pabazuar edhe propozimin për caktimin e masës siguruese, e poashtu për këtë propozim nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara në dispozitën e lartë theksuar. Kundërshtarët e sigurimit në kundërshtime theksojnë se propozimi i propozuesit me të cilën kërkon që të ndërpritet transmetimi dhe ritransmetimi por pa e specifikuar se për cilën lëndë bëhet fjalë, është kërkesë e pabazuar, formulim i përgjithësuar, i paqartë pasi që nuk është i drejtuar nga sendi konkret apo një pjesë e tij. Për më tepër ritransmetimi i përmbajtjes programore është i rregulluar dhe i mbështetur në kontrata për të drejtat e ritransmetimit të deponuara në KPM. Ndërsa sa i përket propozimit të dytë “për bllokim të llogarive bankare”, kjo kërkesë është e pabazuar, e palejuar, e pa arsyetuar, kërkesë kjo e cila mund të kërkohet vetëm me padi. Kundërshtarët e sigurimit, në kundërshtimet e tyre i konsiderojnë të pabazuara pretendimet e propozuesit lidhur me kërkesën e tij për shpërblim pasi që në kuptim të nenit 182 të Ligjit për të drejtat e Autorit dhe të drejtat tjera të përafërta, një e drejtë e tillë nuk mund të aplikohet tek administrimi kolektiv i të drejtave të autorit, pa e ditur se për cilat të drejta bëhet fjalë, e poashtu kundërshtarët e sigurimit në parashtrime kanë kundërshtuar edhe për faktin se çështja e tarifave nuk është përfundimtare dhe së shpejti do të jetë objekt negociimi me Qeverinë e Kosovës. Poashtu në kundërshtime, kundërshtarët kanë theksuar se propozuesi i sigurimit në cilësi të shoqatës nuk ka arritur të sigurojë autorizimin e të gjithë autorëve, me përjashtim ka siguruar autorizim nga dy televizione dhe nëntë aktorë. Mbi këtë bazë konsiderojnë se propozuesit i mungon e drejta subjektive për t’a paraqitur një propozim të tillë. Andaj i propozojmë gjykatës që propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurisë, t’a refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Kundërshtari i pestë i sigurimit përmes të autorizuarit të tij, në kundërshtimet e shprehura në parashtrësën e datës 14.07.2021 si dhe verbalisht në seanca, ka kundërshtuar në tërësi propozimin për caktimin e masës së sigurimit, me arsyetimin se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e masës në kuptim të nenit 297, par. 1 pika a) dhe b) të LPK-së, duke qartësuar se propozuesi nuk e ka bërë të besueshme kërkesën apo të drejtën subjektive si dhe rrezikun se pa caktimin e masës së tillë, pala kundërshtare do t’a pamundëson apo vështirëson realizimin e kërkesës. Kundërshtari i sigurimit në kundërshtimet e tij ka theksuar se propozuesi përmes propozimit kërkon që të ndërpritet transmetimi dhe ritransmetimi i lëndës së mbrojtur pa e specifikuar se për cilën lëndë të mbrojtur bëhet fjalë, e që e bën kërkesën të pabazuar, të paqartë, të përgjithësuar e jo të drejtuar nga sendi konkret apo një pjesë e tij. Për më tepër, ritransmetimi i përmbajtjes programore është proces i rregulluar ndaras dhe i mbështetur në kontrata për të drejta ritransmetimi të cilat deponohen në KPM. Më tej kundërshtari i sigurimit thekson se

propozuesi i sigurimit kërkesën e tij e ka bazuar në nenin 186 të Ligjit për të drejtat e Autorit dhe të drejtave tjera të përafërta me pretendimin se kjo është dispozitë speciale e cila mbizotëron normat e LPK-së mirëpo kjo dispozitë ka të bëjë me sigurimin e provës dhe jo me masat siguruese. Më tej kundërshtari i sigurimit në kundërshtimet verbale ka theksuar se besueshmëria e kërkesës (siç pretendon propozuesi) nuk konstituohet me vlerësime paushalle të përafërta e i cili nuk ka njohuri as për numrin e abonentëve të cilët i ka kundërshtari i pestë i sigurimit andaj në mënyrë paushallë precizon kërkesën për masë siguruese. Poashtu në kundërshtime, kundërshtari ka theksuar se propozuesi nuk e ka bërë të besueshme të drejtën subjektive mirëpo tenton që mbi bazën e parimit “prima facie” të vendoset për këtë propozim, e poashtu propozuesit i mungon autorizimi nga bartësit e të drejtës së autorit, andaj mbi këtë bazë i propozojmë gjykatës që propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurisë, t’u refuzojë ne tërësi si të pa bazuar.

Pas analizimit të parashtrimeve të palëve si dhe provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës gjykata ka aprovuar propozimin për caktimin e masës siguruese, si në propozim të propozuesit, në kuptim të dispozitës së nenit 297 paragrafi 1 pika a) dhe pika b), të LPK-së, e cila parasheh se *“masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij” dhe b) “në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”*. Mbi bazën e asaj që u tha më lartë, gjykata konstaton se propozuesi i sigurimit i bëri gjykatës të besueshme të drejtën e tij subjektive apo të drejtën e kërkesës e cila propozuesit i njihet me Ligjin për Pronësinë dhe të drejtat e Autorit dhe të drejtat e përafërta, e mbi bazën e së cilës në kuptim të nenit 171 dhe 172 propozuesi ka marrë licencën për ushtrimin e aktivitetit të “shoqatës për administrim kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta” e poashtu propozuesi i sigurimit ka edhe autorizimin e disa subjekteve për ushtrimin e të drejtave kolektivisht sipas Ligjit për të drejtën e Autorit. Poashtu gjykata konstaton se organi përkatës Qeveria e Kosovës me vendimet 12/36 të datës 19.10.2020 dhe 13/38 të datës 30.10.2020 ka aprovuar tarifën duke caktuar shumën për abonues varësisht nga numri i kanaleve, e poashtu nga shkresa e Qeverisë së Kosovës Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Zyra për të drejtat e Autorit rezulton se kjo zyrë ka licencuar propozuesin VAPIK, si shoqatë që përfaqëson autorët vizual, producentët, interpretuesit për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, me të drejtë përfaqësimi të tyre.

Derisa nga kundërshtimet e kundërshtarit të sigurimit për t’u paguar tarifën e përcaktuar të Qeverisë, rezulton se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së sigurimit pala kundërshtare do të vështirëson realizimin e kërkesës.

Rrjedhimisht nga të lartë cekurat gjykata ka ardhur në përfundimin se propozuesi i sigurimit e ka bërë të besueshme kërkesën e tij andaj edhe është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Siç është potencuar edhe në dispozitiv të këtij aktvendimi, kjo masë siguroese mbetet në fuqi deri në vendimin e ardhshëm gjyqësor.

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartcekura si dhe në dispozitat ligjore të cituara më sipër, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Ekonomike
V.EK.nr.413/21, me datë 28.07.2021

Gjyqtari,
Faton Bajrami

KËSHILLË JURIDIKE: Ndaj këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e marrjes së tij, duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.